

VENDIM
Nr.42, datë 13.1.1997

**PËR DOKUMENTACIONIN E PERIUDHËS SË SIGURIMIT (TË VJETËRSISË NË PUNË)
DHE PLOTËSIMIN E DOKUMENTEVE NË RRUGË GJYQËSORE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dokumentacioni i periudhës së sigurimit (të vjetërsisë në punë), për anëtarët e ish-kooperativave bujqësore, deri tani të administruara nga komunat, të administrohet nga agjencitë dhe degët e sigurimeve shoqërore në rrethe, nëpërmjet punonjësve të tyre në komuna dhe bashki.

Për ushtrimin e kësaj veprimtarie këshilli i komunës dhe i bashkisë të vërë në dispozicion të sigurimeve shoqërore një mjedis të përshtatshëm dhe të sigurt deri më 1.2.1997. Dorëzimi i dokumenteve të bëhet me aktdorëzimi dhe të përfundojë brenda datës 1.5.1997.

2. Ndërmarrjet dhe institucionet buxhetore e jobuxhetore, të cilat kanë ndërprerë aktivitetin e tyre (dhe nuk e kanë dorëzuar dokumentacionin në arkivat e rretheve) ose janë drejt mbylljes, të bëjnë azhurnimin e plotë të dokumentacionit të periudhës së sigurimit (të vjetërsisë në punë) të punonjësve, duke përputhur listëpagesat, regjistrat themeltarë dhe librezat e punës, brenda datës 1.4.1997. Brenda datës 1.5.1997 librezat e punës u jepen punonjësve përkatës, ndërsat regjistrat themeltarë depozitohen në organet e sigurimeve shoqërore me procesverbale të rregullta.

3. Në ndërmarrje, institucione, shoqëri tregtare dhe persona të tjerë juridikë, kur aktet që vërtetojnë vjetërsinë në punë, saktësinë e pagës, llojin e punës dhe aksidentin në punë janë zhdukur, kanë humbur dhe nuk mund të bëhen përsëri ose nuk mund të merren në ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që këto fakte të vërtetohen në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.274, datë 16.7.1988 dhe nr.14, datë 10.1.1992, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi